



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 396 Prot.

Tiranë, më 19 . 02 . 2026

V E N D I M

Nr. 38 , datë 19 . 02 . 2026

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 41 Regj., datë 05.02.2026, të shtetasit A. M, kundër: Njesisë Administrative Nr.4/Bashkia Tiranë, Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve, pranë Njesisë Administrative Nr.4/Bashkia Tiranë dhe Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Tiranë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes ekonomike”, “gjendjes arsimore”, “përgjegjesisë prindërore”, “gjendjes familjare” dhe “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, shtetasi A. M, në shpjegimet e paraqitura para Komisionerit, është shprehur, si më poshtë vijon:

“Unë ankuesi A. M, kam bërë video për informacion kundrejt Njesisë Administrative Nr. 4, Tiranë. Gjithashtu kam depozituar kallëzim penal kundrejt Njesisë Administrative Nr. 4, për shkakun e ngjarjes së tërmetit të vitit 2019, dhe për shkak se kjo strukturë nuk më ka ndihmuar asnjëherë më këshillim juridik në drejtim të përfitimeve që më akordon ligji, pasi unë jam kthyer familjarisht nga shteti francez së bashku me familjarët.

Së fundmi, kam pësuar një dëmtim shëndetësor, thyerjen e kockës së këmbës së majtë dhe jam në pamundësi objektive – fizike për të siguruar të ardhura për familjen.

Kësisoj kam aplikuar 3 (tre) herë radhazi për ndihmë ekonomike dhe subjektet diskriminuese kanë mohuar përfitimet që më jep ligji. Madje, znj. N. M, Adminsitratore e komanduar pranë kësaj Njësie, më ka thënë verbalisht dhe vazhdimisht këto fjalë: “Më ke çuar (bërë kallëzim)

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin: KMD.

tek Sektori Ekonomik në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë dhe nuk do ta harroj kurrë...ke për ta mbajtur mend!”

Së fundmi, më datë 06.01.2026, ora 18:27, më ka telefonuar nëpunësja e znj. N duke më bërë shantazh e presion, me qëllim për të më hapur një procedurë administrative gjoja me justifikimin se unë nuk paskam dërguar fëmijët e mi në shkollë. Sa më sipër, zonja në fjalë pretendon se këtë lajm ia ka dërguar Drejtorja e Shkollës “Ardian Klosi” dhe psikologja e kësaj Shkolle. Duke qenë se ky lajm është i pavërtetë kam disponuar me kallëzim penal kundrejt personave përgjegjës.”

Në përfundim, subjekti ankues, ka kërkuar nga Komisioneri: *“Konstatimin e diskriminimit për shkaqet e pretenduara, lidhur me mohimin e së drejtës për ndihmë ekonomike nga shteti; si dhe, ndalimin e menjëhershëm të diskriminimit dhe detyrimin e subjekteve të më akordojnë ndihmën ekonomike që nga momenti i mohimit të saj.”*

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Nga këqyrja e analizimi i dokumentacionit të dërguar pranë KMD-së, rezulton se:

- Subjekti ankues më datë 08.08.2025, ka plotësuar formularin e aplikimit për ndihmë ekonomike, pranë Njesisë Administrative Nr.4/Bashkia Tiranë, asistuar nga Administratori Social pranë kësaj Njësie, znj. A. K.
- Me kërkesën nr. 2727 prot., datë 04.09.2025, z. M ka kërkuar informacion nga Njësia Administrative Nr.4/Bashkia Tiranë, mbi refuzimin e përfitimit nga mbrojtja sociale².
- Për sa mësipër, nëpërmjet shkresës me nr. 2727/1 prot., datë 10.09.2025, Njësia Administrative Nr.4/Bashkia Tiranë, informon ankuesin se:

“Në zbatim të VKM nr. 855, datë 26.12.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, të ndryshuar, Kreu II, pika 1.1, theksohet se administratori shoqëror hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar të dhënat e aplikimit.

Dhe, referuar pikës 9, kreu II, të VKM -së sipërcituar, mbas verifikimit të të dhënave të deklaruara, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social realizon procesin e vendimmarrjes.

Referuar sistemit elektromik të ndihmës ekonomike, familja juaj është përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike duke u trajtuar për periudhën 01.10.2019 – 30.09.2022.

Ju z. M keni riaplikuar në muajt në vazhdim në Regjistrin Kombëtar të Ndihmës Ekonomike, ku përgjatë vitit 2025 keni aplikuar në muajt korrik dhe gusht, nga ku sistemi i pikëzimit i ka refuzuar aplikimet me arsyen “Nuk ka marrë pikët e mjaftueshme”. Gjithashtu, ju keni aplikuar edhe për muajin shtator 2025, për të cilin pritet vendimmarrja brenda këtij muaji.

Detyrë e adminsitatorit shoqëror është hedhja e të dhënave që ju deklaroni, sa herë që ju paraqiteni për aplikim.”

² Ky fakt evidentohet nga shkresa “Kthim përgjigje” me nr. 2727/1 prot., datë 10.09.2025, e Njesisë Administrative Nr.4/Bashkia Tiranë.

- Nisur nga përmbajtja e procesverbalit “Për kallëzimin e veprës penale”, të datës 06.01.2026, depozituar nga ankuesi, rezulton se, ky i fundit ka paraqitur një kallëzim pranë organit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, lidhur me pretendimin për shantazhim, kërcënim, poshtërim dhe shfrytëzim i detyrës, autoritetit shtetëror, kundrejt punonjësës së Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve, pranë Njesisë Administrative Nr.4/Bashkia Tiranë dhe Administratores së kësaj Njësie.

Sa i takon pretendimit të ankuesit se është diskriminuar nga ana e Njesisë Administrative Nr. 4/Bashkia Tiranë, Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve, pranë Njesisë Administrative Nr.4/Bashkia Tiranë dhe Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Tiranë, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Së pari, subjekti ankues ka pretenduar që është diskriminuar nga ana e subjekteve sipërcituar, duke shënjuar në formularin e ankesës shkaqet e: *gjendjes ekonomike, gjendjes arsimore, përgjegjesisë prindërore, gjendjes familjare*, por pa dhënë asnjë shpjegim, apo sqaruar rrethana me fakte e prova se si ai është trajtuar në mënyrë të padrejtë apo të pafavorshme nga ana e këtyre subjekteve respektivisht, apo se si ky trajtim lidhet me secilin prej këtyre shkaqeve.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllajta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë³”*

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminimi” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga

³ Shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese.

KEDNJ, gjithashtu çenohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve objektivisht e ndryshme.

Ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë mbrojtjen nga diskriminimi respektivisht edhe për shkaqet e pretenduara nga ankuesja.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Duke mbajtur në konsideratë standardet dhe parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues nuk ka ngritur pretendime për diferencë në trajtim ose për dështimin nga ana e strukturave respektive të Njësisë Administrative Nr. 4/Bashkia Tiranë (apo dhe DRSHS Tiranë) për të trajtuar ndryshe rastin e tij, për shkak të situatës në të cilën ai

gjendet, situatë e cila supozohet se ka si shkak *gjendjen ekonomike, gjendjen arsimore, gjendjen familjare dhe përgjegjësinë prindërore*, të tij.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkaqet sipërcituar, Komisioneri vlerëson se, vetëm fakti që një person posedon këto shkaqe, nuk mjafton për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për shkaqet e pretenduara, por jo vetëm, duhet të parashtrojë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun e mbrojtur, që në çështjen objekt shqyrtimi janë: *gjendja ekonomike, gjendja arsimore, gjendja familjare dhe përgjegjësia prindërore e ankuesit*.

Pala ankuese nuk parashtroi fakte apo rrethana nga të cilat të mund të prezumohet se ka patur sjellje, veprime apo mosveprime të institucioneve përgjegjëse që të jenë motivuar nga shkaqet sipërcituara⁴.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Së dyti, lidhur me pretendimin se diskriminohet “për çdo shkak tjetër”, ankuesi ka shënjuar faktin se është administrator i domainit publik “Zhurma.AL⁵”, por duke shtjelluar faktin se punonjëset e Njësisë Administrative Nr.4, Tiranë (përfshirë Administratoren) dhe se janë hakmarrë kundrejt tij për shkak të kallëzimit të depozituar prej tij në Prokurori.

Lidhur me sa mësipër, Komisioneri vëren se, nga këqyrja e procesverbalit të kallëzimit, të depozituar pranë KMD-së në cilësi prove, rezulton se subjekti ankues ka depozituar kallëzimin, pas veprimeve të pretenduara të punonjëseve të Njësisë. Për rrjedhojë, përveçse shprehjet e cituara janë të karakterit deklarativ⁶ nuk provohet që mes tyre dhe veprimeve të pasuara të ketë një korrelacion kronologjik kohor. Kallëzimi në Prokurori është depozituar nga ankuesi më datë 06.01.2026, në orën 18:27, ndërkohë që ka kallëzuar punonjëset e Njësisë, për “ngjarjen” e ndodhur në orën 14:22, të po asaj dite.

Rezulton se gjithë narrativën për diskriminim bazuar mbi këtë shkak, (“çdo shkak tjetër”, duke shtjelluar denoncimet e tij) ankuesi e ka ngritur duke shtjelluar pretendimin e tij për diskriminim vetëm kundrejt Njësisë Administrative Nr.4/Bashkia Tiranë dhe në asnjë moment nuk e lidh këtë shkak me subjektin e DRSHS Tiranë.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33, pika 4, shkronja “b”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar⁷, Komisioneri

⁴ Për analogji citojmë vendimet: nr. 107, datë 20.06.2023, nr. 122, datë 05.07.2023, nr. 45, datë 03.03.2025, të KMD-së.

⁵ Pa dokumentuar e provuar me dokumentacion, fakte e prova.

⁶ Më ka thënë verbalisht dhe vazhdimisht këto fjalë: “Më ke çuar (bërë kallëzim) tek Sektori Ekonomik në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë dhe nuk do ta harroj kurrë...ke për ta mbajtur mend!”

⁷ Neni 33, pika 4/b, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcakton se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b)është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji”.

arrin në përfundimin se, ankesa e paraqitur nga subjekti ankues A. M kundër: Njesisë Administrative Nr.4/Bashkia Tiranë, Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve, pranë Njesisë Administrative Nr.4/Bashkia Tiranë dhe Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Tiranë; nuk mund të pranohet, pasi është e papajtueshme me dispozitat e ligjit dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës me nr. 41 Regj., datë 05.02.2026, të subjektit ankues A. M, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA